



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/34.1

Datë: 05.06.2019

PROCESVERBAL

i mbledhjes së III-të (tretë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- të rregullt dhe mbledhjes së -I- të jashtëzakonshme të vitit 2019.
2. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve nëpër vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597 datë:06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorç, KK.Malishevë.
4. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/159 datë:12.02.2019, për miratimin e aneks-Planit Komunal të veprimit për Eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021.
6. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
7. Shqyrtimi i Raportit nr.02/67 datë: 04.02.2019 të KRU "Hidroregjioni Jugor", njësia operative në Malishevë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës nr.01/138 datë:08.02.2019 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.
9. Shqyrtimi i Raportit nr.11/85 datë:12.02.2019 të DKAE-së, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/188 datë:20.02.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për marrjen e vendimit, sipas kërkesës nr.01/176 datë:14.02.2019 të parashtruar nga kryesia e Lagjes Matoshi-Qytetit të Malishevës, për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit të Komunitetit "Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit".
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/201 datë:22.02.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për vazhdimin e mandatit të kryetarëve dhe kryesive të fshatrave dhe vendbanimeve tjera, deri në zgjedhjen e kryetarëve të rinj.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/185 datë:22.03.2019, për miratim të projekt-Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027 të Komunës së Malishevës.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/117 datë:05.02.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës sipas kërkesës nr.01/78 datë: 24.01.2019 për ndërtimin e objektit të Xhamisë në fshatin Terpezë të Poshtme.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/11 datë:07.02.2019 të parashtruar nga Feim Krasniqi nga fshati Llashkadrenoc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/12 datë:09.02.2019 të parashtruar nga Ismet Rudaj nga fshati Panorc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/14 datë:08.02.2019 të parashtruar nga Baki Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/22 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Bahte Bytyqi nga fshati Shkozë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/31 datë:18.03.2019 të parashtruar nga Blerim Krasniqi nga fshati Llashkadrenoc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/158 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, për caktimin e zonës së mbrojtur të Memorialit të UÇK-së në kodrën e quajtur Golesh në Malishevë.
20. Shqyrtim i kërkesës nr.02/131 datë:11.03.2019 të parashtruar nga banorët e lagjes Brahaj nga fshatit Carrallukë.
21. Shqyrtimi i kërkesave për ndërtim të shtëpive për familjet e pa strehë.
22. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/164 datë: 13.03.2019 të parashtruar nga fshatit Llazicë, Vermicë dhe Drenoc.
23. Miratimi i dorëheqjes së anëtares znj.Vera Bytyçi nga Komiteti për Barazi Gjinore.
24. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 29.03.2019 dhe filloi në ora 10:39 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 23 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë ju të pranishëm e hapi mbledhjen e III-të të rregulltë. Fillimisht është debati para rendit të ditës dhe ju lus që debati të jetë konstruktiv dhe t'i përmbahemi Rregullores së Punës së Kuvendit. E hapi debatin jashtë rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Fillimisht ju njoftoj që është bërë një organizim dhe njoftim për aksionin e dhurimit të gjakut që tashmë më është bërë si traditë. Koha e dhurimit të gjakut është nga ora 11-16 në xhaminë e fshatit e organizuar nga rinia e Dragobilit.

Çështja për të cilën do të diskutoj është vizita e mësuesëve pensionistëve në Korçë. Gjatë shqyrtimit të buxhetit që kemi bërë për v. 2019 me kërkesë të drejtorit të Arsimit e kemi mbështetur kërkesën e tij dhe i kemi dhënë goxha hapësirë finaciare asaj kërkesë për organizimin e vizetës të mësimeve pensionistë në Korçë. Para disa ditësh është realizuar kjo vizitë, por përbërja e tyre që kanë marrë pjesë nuk ka qenë e duhura. Është keqpërdorur besimi ynë dhe vota jonë sepse një autobus e më shumë ka pas pjesëmarrës që nuk kanë pas lidhje me pensionistët siç janë drejtorët e shkollave, stafi i drejtorit të Arsimit dhe nga stafi i Kryetarit. Kërkoj nga drejtori

që të bëjë një raport për këtë vizitë për mbledhjen e ardhshme për se çfarë statusi kanë pas pjesëmarrësit, sa ka kushtuar kjo vizitë dhe cila ka qenë agjenda.

Çështja tjetër ka të bëjë me projektin e lumit "Mirusha" shetësim i imi është se mënyra se si po bëhet ky projekt është degradim i lumit me beton dhe mbytet flora dhe fauna me duart tona dhe për mua ky është krim.

Si Kuvend keni bërë gabim të madh kur e keni futur pjesën e kompenzimeve edhe me tokë për shpronsimet rreth lumit. Për 1 ari tokë këtu 3 ari tokë po jepen te stadiumi pra edhe ajo pak tokë po jepet në emër të këtyre kompenzimeve. Ku duam të shkojmë ne kështu?!

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Mbase tani është "Java e Gruar" dua të flas për ku në kohët e fundit jan shtuar rastet e dhunës në familje. Ne kemi bërë shumë pak për gruan. Pra 10 ditë ka pausr dhunë në familje dhe policia ka gjetur edhe armë pa leje të burrit të saj.

Kryetar a raporton Qendra Sociale juve dhe Komandatit të Policisë për këtë fenomene të dhunës dhe cilat janë masat që i merrini? Sepse në rastin e dhejetorit burri e ka kërcuan gruan që do ta vras kur të vie nga kurbeti, a kemi ne mekanizma që ta mbrojmë këtë grua? Nëse ndodh ndonjë gjë e keqe si do të përgjigjemi ne?

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Shqetësim i imi dhe i gjithë qytetarëve tanë është kriminaliteti si dukuri e përhapur siç janë vjedhjet, vjedhet e rënda, mashrimet, uzorpiimi i pasurisë duhet të sanksionohen me kodin penal të Kosovës dhe atë ndërkomtar. Numri i këtyre veprave negative çdo ditë po rritet në shumë fshatra dhe lokacione në komunën tonë.

Para disa ditësh në fshatin Bardh kanë ndodhur dy vjedhje të rënda dhe përveç dëmtime materiale qytetarët ndjehen të rrezikuar. Mendoj që kjo gjendje është kaotike, alarmante dhe tepër shqetësuese.

Meqë këto raste të vjedhjeve çdo ditë po shtohet kërkoj që të rritet numri i patrollave policore në kohët e vona dhe të ashpërsohen politikat dëshkuese ndaj kryesëve të këtyre veprave penale.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Diskutimi im ka të bëjë me mbledhjen e kaluar ku është marr një vendim nga ana individuale nga Kryesuesi për përfundimin e mbledhjes pa i përfunduar edhe 7 pika të rendit të ditës pasi është votuar rendi i ditës nga Asambleja dhe mendoj që janë bërë shkelje procedurale. Kryesuesi ka marrë vendim që për shkak të kourrumit të përfundojë mbledhjen, ama mbledhja ka mund veç të ndërprehet deri sa të sigurohet numri i kourrumit të anëtarëve të Asamblesë dhe të vazhdoj mbledhja e jo të thirret mbledhje e rregulltë pa përfunduar ajo. Ky ishte një vendim individual i Kryesuesit edhe pse vendimet duhet të merren nga shumica e anëtarëve të Asamblesë.

Kjo mbledhje është thirr para 2-3 ditësh e sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 43 mbledhja duhet të thirret 7 ditë pune para mbledhjes. Pra është shkelur ligji.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kjo temë është diskutuar këtu disa herë por Kryetar në Carrallukë kemi problem me kanalizimin i cili po dëmton edhe ujin e pijes. Qytetarët disa herë kanë qenë këtu por ju nuk ju keni ofruar zgjidhje gjithaashtu kanë qenë edhe në stacionin e Policisë por ata ju kanë drejtuar Institutit të Hidroregjionit në Prishtinë dhe ata i kanë bërë analizat e ujit. Sipas këtyre analizave uji është i kontaminuar dhe nuk i plotëson kushtet as për higjenë se për pije jo se jo.

Kryetar, çfarë do të bëni me këtë kanalizim ku vende vende edhe pse është intervenuar rrjedh mbi tokë, dhe çka do të bëni për ujin e pishëm?

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Rruga që ka filluar të shtrohet e që lidh fshatrat Astrazup-Burim qytetarët kanë kërkuar edhe kanalizimin në atë pjesë, në buxhetin e 2019-tës është paraparë 50 m kanalizim tek “Lagjia e Re”, por duhet specifikuar tani më mirë se në cilën pjesë do të punohet kanalizimi sepse ajo pjesë ka probleme me kanalizimin.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Çështja që dua të diskutoj është për vizitën e mësimdhënësve pensionistë në Korçë. Përveç pensionistëve këtu kanë marrë pjesë edhe drejtorët e shkollave, stafi i Drejtorisë së Arsimit. Pse kanë marr pjesë në vizitën e Korçës edhe persona tjerër përveç mësimdhësëve pensionistë?

Kryetar, Nënkryetari i komunës i bënë 4000-5000 km në muaj me veturë zyrtare, a ka vendim për përdorimin e veturës zyrtare 24 orë në ditë? Nëse ka duhet ta prezantoni këtu sepse ato para janë të qytetarëve ose t'i nxjerret një vendim për ndalimin e përdorimit të veturës jashtë orarit zyrtar të punës.

Në raportin e fundit që ka sjellë Drejtoria e Finacave askund nuk e shohim Drejtorinë e Inspektoriatit apo ashtu siç e kemi vërjetur që po figuron në emër të Drejtorisë së Bujqësisë si kod 421 e ne shpesh herë po e kundërshtojmë drejtorin për këtë ndoshta ai bënë punë në terren dhe ka të hyra nga Inspektoriat mirëpo nuk ka kod të veçantë për të hyrat.

Kryetar dënimet e gjykatës janë marramendëse në komunën tonë ku për vitin 2018 janë mbi 100,000.00€. A ka mundësi të ketë ndonjë marrëveshje në mes të avokatëve të ndryshëm, avokatëve të komunës që këto mjete qëllimisht po ndahen ndërmjet njerëzve? Çdo lëndë K. e Malishevës po e humb në gjykatë.

Në hyrje të qytetit nga Banja ka aksidente trafiku për shkak ujit që rrjedhi mbi rrugë. Do të ishte mirë që t'i merrni masat.

Kryesues kam një vërejtje për ju dhe stafin e juaj për vonesën e shpërndarjes së materialit dhe nuk është hera e parë që po vonohet. Ka raste kur materialet tona lihen nëpër lokale dhe nuk shpërndahen nëpër shtëpi.

Astrit Sertolli: Pershendetje për të gjithë! Do të ngrija një çështje për QKMF-në, respektivisht për Repartin e Pediatrisë. Dua të di se pse mungon aq shumë mejkua dhe a ka mundësi që të zëvendsohet me një pediatër tjetër në mënyrë që pacientët të mos presin shumë në rradhë?

Kryetari – Ragip Bega: Pershendetje për të gjithë! Do të përpiqem që t'u jap përgjigje pyetjeve të juaja që parashtruat këtu de t'i paraqes disa çështje të mija.

Sa i përket vizitës së mësimdhënësve pensionistë në Korçë sipas mendimit tim të konsiderohet veteranë i arsimit veç ai që e ka përfunduar punën e tij duke u pensionuar në arsim, mirëpo kanë dëptuar edhe disa që janë pensionistë por që kanë punuar më heret në arsim edhe pse nuk janë pensionuar aty. Mënyra se si është zhvilluar më tutje kjo vizitë nuk kam më shumë informata, por mua më kanë falemnderuar për këtë vizitë disa nga ta.

Çështja e lumit Mirusha është diskutuar këtu dhe jam munduar që gjithë jetën të punoj ndërgjegjshëm. Shpronësimi është për sipas procedurave ligjore dhe ministria e ka vlerësuar kompenzimin.

Hidajete, janë disa çështje që janë më shumë familjare dhe ligjore të organeve të policës dhe gjyqsisë dhe ne nuk mund të merremi me to sepse nuk kemi kopetenca. Do të doja që të mos kishte kurrë dhunë familjare.

Valon, hajnia është fenomen që ndodh në të gjitha vendet vendet e botës pavarësisht angazhimit institucional në përgjithësi. Por kërkesa për Stacione e Policisë është me vend.

Luan këso fomra të thirrjes së mbledhjeve kanë ndodhur edhe më heret por kemi pasur mirëkuptim për shkak të rrethanave që krijohen ndonjëherë.

Ilaz e di shqetësimin e banorëve të Carrallukës dhe me kanalizime kemi problem pothuajse në shumicën e fshatrave të K.së Malishevës. Duhet të ketë edhe një vedijësim për qytetarët sepse ujërat e shiut si mbanë asnjë kanalizim sepse shkon uji me rërë e gurë dhe mbeturina tjera e që e mbyll kanalizimin. Një sqarim më të hollësishëm do t'jua jep edhe drejtori.

Rruga e Burimit është në buxhet të vitit të kaluar e i kemi bartur për këtë vit e sa i përket kanalizimit unë nuk e di, drejtori sigurish do t'ju informojë.

Është ligji për përdorimin e veturave zyrtare dhe as një veturë nuk e kam të caktuar për individë të caktuar. Ne kemi kursyer në vitin e kaluar 50% të derivateve që janë paraparë për shkak që i kemi menaxhuar mirë. Sa km i ka bërë Nënkrjetari nuk e di veç ai më zëvendson mua për gjitha ato punë që nuk mund t'i mbërrijë.

Sa i përket dënimve gjyqësore ato shpeshherë janë të padrejta siç është çështja e 3 pagave për ata që dalin në pension që është e rregulluar me ligj por jo me buxhet po na dëmton shumë neve.

I kam dy çështje që njëherë kam kërkuar që sot të futet në rendin e ditës dhe kisha dashur që t'më është për fabrikën në Mirushë, që kërkoj shfuqizimin e vendimit dhe çështja tjetër për Ben-afin. Unë kam një takim me një donator që në mundsha do të filloj të ndertoj dy shtëpi, për çdo gjë i keni drejtorët këtu.

Rrahim Morina: Sa i përket fabrikës në Mirushë të Agimi Krasniqit është vendimi i KPF-së që është ndarë për të gjitha bizneset e që u është mundësuar pa qera. Ai ka qenë vendim i KPF-së jo i Kuvendit dhe shkeljet që kanë bërë këta atëherë po mundohen t'ja hedhin Kuvendit tani. Ne ja kemi bërë ndërimin e veprimtarisë së biznesit dhe kemi pritur një përgjigje nga MAPL-ja por ajo s'na ka dhënë asnjë sqarim lidhur me këtë.

Kalojmë në debatin për rendin e ditës dhe kërkoj falje për vonesën e materialit shkak është që e kemi pritur PZHK-në.

Blerim Thaçi: Pershendetje për të gjithë! Gjatë vizitës në Korçë të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë pensionistë që janë pensionuar në arsim, që kanë punuar në arsim dhe ju falemnderoj juve për mbështetjen që na keni dhënë në ndarjen e buxhetit. Ne do ta bëjmë një raport për këtë.

Po kanë qenë edhe drejtorët e shkollave që kanë shkuar si menaxher i stafit të vetë për pensionistë. Pjesëmarrës të tjerë kanë qenë 4 nga Drejtoria dhe 1 nga stafi i Kryetarit.

Rrahim Morina: Kalojmë në debatin për rendin e ditës. E kam një kërkesë timen që duhet të shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës me nr. 02/483 i datës 20.11.2018 për lirimin nga taksa komunale për leje ndërtimi në bujqësi. Ne si Kuvend kemi kërkuar sqarime shtesë nga MAPL-ja dhe dje kam qenë në Zyren Ligjore dhe sipas tyre lirohen vetëm objektet që janë të ndërtuar në pronën publike dhe që është objekt publik. Ansaj ky vendim kërkohet të anulohet dhe kërkoj që të hyjë në rendin e ditës.

Kërkesa tjetër është e Kryetarit e që është për plotësimin e ndryshimit të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/131 i datës 07.03.2019, përkatësisht neni 8, paragrafi 8.1 i Rregullores nr. 02/340 e datës 04.11.2016 për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike. Çështja është për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Kërkesa tjetër e Kryetarit është inicimin e procedurave për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/564 i datës: 26.12.2018 të nxjerrë nga mbledhja e mbajtur me 21.12.2018. Përveç kësaj është edhe vendimi tjetër që duhet të shfuqizohet që është marrë me datë. 04.07.2003 me nr. protokoli 01/440 që i është dhënë kësaj kompanie nga Kryetari i Kuvendit Gani Krasniqi. Pra kërkohet që këto dy vendime të shfuqizohen.
E hapi debatin për rendin e ditës.

Alban Mazreku: Ne si grup kërkojmë që pika e 3-të të hiqet nga rendi i ditës për arsye të mosrespektimit të procedurave si dhe lënda është në gjykatë.
Kërkojmë që të hiqet nga rendi i ditës pika e 11-të pasi që ne sot do të krijojmë komisionin për zgjedhjet e reja nëpër fshatara për kryetar të fshatrave.
Pika e 12-të kërkojmë që të hiqet nga rendi i ditës sepse materiali është shumë voluminoz PZHK-ja dhe nuk kemi mundur që ta shqyrtojmë.
Pajtohem që kërkesa e Kryetarit për marrëveshjen me BIK-unë të futet në redin e ditës dhe të radhitet në 3.

Alban Krasniqi: Pajtohem me propozimet e PDK-së për të tri pikat e rendit të ditës me gjithë arsyet që u dhanë.
Ne propozojmë që të hiqet nga rendi i ditës pika e 13-të që shkresat që kanë ardhur nga të ashtuquajturit kryetarë të fshatrave edhe ju ka skaduar afati atyre shkresave dhe ato mbledhje që kanë pretenduar që janë mbajtur nëpër fshatra nuk janë mbajtur fare. Ato shkresa nuk përkojnë njëra me tjetrën, vendi ku është kërkuar ende nuk është sqaruar sepse ne projekt aty e kemi parë që të ndërtohet një park dhe më e rëndësishja është që ne duhet të dimë për burimin e investimit të objekteve për xhami.

Sylë Dukolli: Mendoj që kur flasim për rendin e ditës nuk duhet paraprakisht të diskutohen pikat e rendit të ditës para se të votohet rendi i ditës.
Ne NISMA e përkrahim në tërësi rendin e ditës. E sa përketë pikës së 3-të me të vërtetë po luhet një cirk me shkollën e Panorcit. Ejani e t'i japim përkrahje këtij projekti sepse shkolla është duke u ndërtuar dhe ta kryejmë formalisht ashtu siç na ka hije këtu.

Valon Krasniqi: Ne pajtohem si grup me propozimet e Alban Mazrekut por ne kërkojmë që të futet në rend dite edhe propozimet e Kryesuesit.

Kastrito Berisha: Sylë, deri sa ekzekutivi nuk i respekton kërkesat tona pse po kërkon që të futet në rend dite kërkesat e Kryetarit.

Rrahim Morina: Kemi disa propozime. Alban Mazreku propozoi që nga rendi i ditës të hiqen pika 3, 11, 12 dhe të hiqet pika e 13 në përkrahje të 3 grupeve politike PDK, VV, dhe LDK të mos futet në rendin e ditës kërkesa e Kryetarit për inicimin e shfuqizimit të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/564 i datës: 26.12.2018 të nxjerrë nga mbledhja e mbajtur me 21.12.2018. Ndërsa ai kërkon që të futet në rendin e ditës kërkesa e Kryetarit për marrëveshjen me BIK-unë të futet në redin e ditës dhe të radhitet në 3. Kush është për?

Për: 12

Kundër: 9

Abstenim: 2

Propozimi im ishte kështu që të futet në rendin e ditës shfuqizimi vendimi i Kuvendit të Komunës me nr. 02/483 i dhatës 20.11.2018 për lirim nga taksa komunale për leje ndërtimi në bujqësi. E sqarova më heret këtë. Kush është që kjo të futet në rendin e ditës?

Për: 14

Kundër: 8

Abstenim: 0

Me këtë votim futet në rendin e ditës edhe kjo pikë.

Atëherë kush është pro rendit të ditës me ndryshime dhe plotësime?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 8

Me këtë votim aprovet rendi i ditës me ndryshime dhe plotësime. Shkojmë në pauzën e drekës, kthehemi pas një ore.

Atëherë pas pauzës kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- të rregullt dhe mbledhjes së -I- të jashtëzakonshme të vitit 2019. E hapi debatin.

Mbase s'ka debatues shkojmë në votim. Kush është pro aprovimit të këtyrë dy procesverbaleve?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve nëpër vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane. Shkojmë direkt me propozimet. Nisma i ka tre vende.

Avdi Morina: Ne grupi ynë propozojmë Luan Kryeziun, Filloreta Bytyqin dhe Hafir Rexha si anëtarë të këtij komisioni.

Alban Mazreku: Ne propozojmë Raimonda Krasniqin, Ali Morninën dhe Nebih Bibaj.

Diana Hoti: Grupi ynë i LDK-së propozon Valon Krasniqin.

Hidajete Mazreku: Ne VV-ja propozojmë për këtë komision Iliaz Krasniqin dhe Veton Zogaj.

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë! Përfaqësues nga Zyra e Kryetarit për këtë komision propozojmë Ahmet Morinën.

Rrahim Morina: I votojmë në pako pra. Nga NISMA janë Luan Kryeziu, Filloreta Bytyqi dhe Hafir Rexha, nga PDK janë Raimonda Krasniqi, Ali Morina dhe Nebih Bibaj, nga LDK-ja është Valon Krasniqi dhe nga VV-je janë Ilaz Krasniqi dhe Veton Zogaj të propozuar për Komisionin për Organizimin dhe Monitorimin e Zgjedhjeve nëpër Vendbanimet, Fshatrat dhe Lagjet Urbane. Kush është për?

Për: unanimit (23)

Me këtë votim unanimit konstituohet edhe ky komision.

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Kërkesa e Kryetarit e që është për plotësimin e ndryshimit të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/131 i datës 07.03.2019, përkatësisht neni 8, paragrafi 8.1 i Rregullores nr. 02/340 e datës 04.11.2016 për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave Publike. E hapi debatin për këtë pikë.

Avdi Morina: Ne si grup kemi shumë shqetësime me punën e Kuvendit Komunal këtu në Malishevë sepse votat e opozitës çdo ditë e më tepër po kthehen në një arrogancë që po largojnë shumë pika nga rendi i ditës e që kto pika të rendit të ditës konsiderohen vitale dhe interetere të qytetarëve të K. së Malishevës. Mendoj që kjo punë siç po vazhdon këtu konsideroj që e dëmton qytetarin e që 5 herë më rradhë largohet pika e rendit të ditës për ndërtimin e shkollës së Panorcit. Duke e parë që situata e tillë po vazhdon pavarësisht asaj që ne donjëhere po mundohemi që t'ju ofrojmë bashkëpunim për të mirën e qytetarëve të Malishevës kjo tani po bëhet e pamundur.

Prandaj, ne si grup çdo herë e kemi ngritur këtë shqetësim që këto pika të rendit të ditës mos të hiqen nga rendi i ditës e të trajtohen e masandaj të merret vendimi çfarëdo qoftë ai, pastaj janë shkeljet tjera në marrjen e vendimit siç është rasti për taksat në bujqësi. Andaj ne si grup kemi ardhur në përfundim që është jo etike kjo dhe ne si grup nuk do të vazhdojmë seancën deri sa ju nuk i merrni për bazë kërkesat Zyrës së Kryetarit, ne lëshojmë sallën.

(grup i NISAM e lëshojnë sallën e mbledhjes)

Rrahim Morina: Atëherë kuorrum s'kemi. Mbas insistimit të Alban Krasniqit vazhdojmë me debat për pikën e 3-të edhe pse s'kemi kuorrum.

Valon Krasniqi: Sa i përketë kësaj rregullore ne pra disa ditësh shefat e grupve politike në përjashtim të VV-jes, Kryetari i Komunës, Kryesuesi dhe 3 përfaqësues nga BIK-u kemi arrdhur në përfundim që të bëhen ndryshimet dhe shuma totale të jetë 230€. Këtë shumë duhet ta ketë parasysh BIK-u që mos të kërkojnë mjete shtesë nga qytetarët.

Ne si grup jemi pro kësaj kërkeje që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i neneit 8.1.

Alban Krasniqi: Pra nesh i kemi dy dokumente: Rregulloren për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave dhe Draft-Marrëveshjen.

Ajo që ne sot po diskutojmë është kjo Draft-Marrëveshje që nuk i ka përfshirë rekomandimet e Komisionit dhe për mua kjo është problematike mos përfshirja e këtyre rekomandimeve dhe vet vendimit të Kuvendit. Në anën tjetër është rritur shuma e shpenzimeve nga 200 në 230€ dhe nuk është dhënë një shpjegim i saktë për këtë rritje të shpenzimeve. Duhet të justifikohet kjo rritje në mënyrë që ne ne ta votojmë këtë marrëveshje.

Një ndër problemet që janë përmendur janë: shpenzimet që ndodhin realisht të kompenzohet BIK-u realisht për ato shpenzime dhe në kuadër të saj çështja e foshnjave të posalindura të trajtohet me një kujdes më të madh. Këto duhet të reflektohen në marrëveshje.

Bazuar me këto që i thash me një takim shtesë në KPF që t'i diskutojmë këto çështje që për mbledhjen e ardhshme të jenë të gjitha të përfshira në marrëveshje e më pas të marrim vendim e që BIK-un e vendosë në një pozicion më të përshtatshëm.

Alban Mazreku: Është e quditshme se si NISMA e lëshon sallën edhe në këtë rast kur është kërkesa e Kryetarit.

Ne kemi mbajtur një takim me Kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesin e BIK-ut dhe kemi ardhur në përfundim që të shtohen edhe 30€ në marrëveshjen e ardhshme me BIK-un. Ne si grup pajtohemi që të ndryshojë neni 8 i rregullores si dhe kjo marrëveshje të vazhdojë edhe me tutje. Te neni 6-të nëse është e mundur të futet edhe raporti i rregulltë 3-mujor për Asamble përveç atij vjetor që është.

Ilaz Krasniqi: Një ndër rekomandimet që ka prezantuar Komisioni është edhe për foshnjat e posalindura që ne kemi kërkuar që çmimi të mos jetë i njëjtë si për të rritur si për foshnja. Pra është mirë që rekomandimet të përfshihen në marrëveshje. Është mirë që të mos të ngutemi e të rregullohet njëherë e mire kjo çështje.

Rrahim Morina: Sqarim. Kjo shuma 30€ është shtuar për çarçafët për terjen e kufomës dhe letra e zezë për varrin si dhe transporti i elemeteve të varrimit. Arkivoli ka qenë 60€ është bërë 70€ dhe shpenzimet kanë qenë 45€ janë bërë 50€. Këto janë ndryshimet që janë bërë për këtë marrëveshje. BIK-u e ka arsyetuar që shpenzimet janë të njëjta si te të rriturit ashtu edhe tek fëmijët prandaj nuk është ndryshuar kjo.

Ali Morina: Dua të lidhem për nenin 1 sepse ka pasur edhe rekomandim nga komisioni që të specifikohen që ata që nuk i përkasin fesë islame ku të aresohen që marrin këtë të drejtë si të gjithë qytetarët e tjerë, sepse në nenin 1 thuhet për qytetarët e fesë islame? Ndërsa disa nga rekomandimet e komisionit janë përfshirë dhe ne e mbështesim këtë marrëveshje.

Muharrem Morina: Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes BIK-ut veç për shërbimet që i ofron BIK-u, mirëpo kjo marrëveshje është derivat i rregullores dhe vendimit të Asamblesë. Nëse i rreferohemi rregullores kanë të drejtë të gjitha bashkësitë fetare që t'i kryejnë këto shërbime. Nëse ka ndonjë bashkësi fetare tjetër ne mund të lidhim një marrëveshje me ta për shërbime të njëjta.

Alban Krasniqi: Lidhur me temën që ngriti prafolësi veç po shtohen arsyet që kjo marrëveshje të votohet në mbledhjen tjetër e që bashkarisht me këtë marrëveshje duhet të nxjerret edhe një vendim i veçantë që e autorizon Drejtorinë e Shërbimeve Publike që të gjithë qytetarëve që janë të besimeve tjera që të vijnë direkt që t'i marrin paratë tek Drejtoria për t'i kryer shërbimet e varrimit sipas besimeve të tyre. Prandaj kërkoja që kjo të diskutohet edhe njëherë në KPF, e thirrjmë edhe komunitetin fetar aty dhe kërkojmë që të diskutohet këtu i rregullojmë aty.

Alban Mazreku: Kryesues, jemi marrëveshje që të ndryshohet neni dhe propozojmë që shuma 200€ të hiqet krejt nga rregullorja dhe nuk jam që të shtyhet për mbledhjen tjetër kjo pikë.

Valon Krasniqi: Ne grupi ynë jemi që kjo të diskutohet sot e të përfundoj sot sepse jemi marrur vesh në takim e jo të shtyhet.

Alban Krasniqi: Unë për shkak të keqpërdorimeve që janë bërë, e lëshoj e sillën deri sa të sqarohen çështje që kemi ngritur këtu.
(Alban Krasniqi lëshon sillën).

Rrahim Morina: Mbase s'kemi kurrë kjo çështje mbetet për të hënë që të vazhdojë kjo seancë. Shihemi të hënë në ora 10 që ta vazhdojmë këtë seancë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:30
Vazhdimi i

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes së III-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës.

Vazhdimi i mbledhjes mbahet me datë 01.04.2019 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 14 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për ju të pranishëm! Mbase PDK-ja nuk janë këtu atëherë s'kemi kuorrum. PDK-ja më ka indormuar për këtë dhe unë e kam lënë një takim për mbasdite me ta. Mbledhja nuk mbahet pa kourrum.

Unë mund që t'ju lejoj deklarinimet vetëm që të biem dakort për mbledhjen që ta vazhdojmë të mërkurën ose ta lëmë krejt që të thirrjm mbledhje të re me datë 12.04.2019. Fjalën e kanë shefat e grupeve pa debate veç deklarinimet.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne NISMA e kemi lëshuar seancën ne javën që shkoj për arsye që u hoqen nga rendi i ditës pikat e Kryetarit me fokus të veçantë pengimi i ndërtimit të shkollës së Panorcit.

Kryesues, ju keni thirrur këtë seancë në vazhdim të saj dhe ne megjithëatë dhe me gjithë paknaqësitë e krijuara nga NISMA ne sot jemi këtu duke respektuar thirrjen tuaj. Ne mendojmë që të mos thirret kjo seancë si vazhdim, por të thirret seancë e rregulltë me datën 12.04.2019 sepse i ka humbur kuptimi i kësaj që po thirret si vazhdim.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne si grup mendojmë që seaca të vazhdojë të mërkurën, ndërsa për datën 12 të jetë vetëm Plani Zhvillimor.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kjo situatë nuk kontribon në zgjidhjen e problemeve ne duhet të jemi korrektë dhe vigjiletë për besimin që na kanë dhënë qytetarët. Kryesues ju merruni vesh me shefat e grupeve dhe caktoni kur të doni mbledhjen.

Rrahim Morina: Nesër në ora 10-të i ftoj shefat e grupeve që të marrim një qendrim për këtë mbledhje. Falemnderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 10: 40

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes mbahet me datë 03.04.2019 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 27 asambleistë, Nënkryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Jemi në vazhdimin e mbledhjes së III-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës dhe kemi mbetur te pika e 3-të e rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Kryesues kërkoj që para fillimit të mbledhjes të mbajmë 1 min heshtje për nderim të tre dëshmorëve Jahir Mazrekut dhe Maliq e Hysen Sopaj sepse sot është përvjetori i rënies së tyre.

Rrahim Morina: Falemnderit Alban! E mbajmë 1 min heshtje në nderim të këtyre dëshmorëve. Lavdi!

Pra, kemi mbetur të pika e 3-të: Kërkesa e Kryetarit e që është për plotësimin e ndryshimit të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02/131 i datës 07.03.2019, përkatësisht neni 8, paragrafi 8.1 i Rregullores nr. 02/340 e datës 04.11.2016 për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave Publike. Kjo pikë është diskutuar dhe nëse kanë diçka kërkoj veç deklaratimet e shefave të grupeve.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Ne grupi ynë kemi propozuar që te pika 8.1 të hiqet paragrafi i fundit që është në emër të mbulimit të shpenzimeve Komuna do të mbulojë shumën finaciare prej 200€ si dhe ta votojmë ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregullore. Kërkoj që KPF-ja me përfaqësuesit e BIK-ut të bëjnë përpilimin e marrëveshjes të re me rekomandimet që i kemi dhënë në mbledhjen e kaluar dhe të vazhdohet më tutje.

Alban Krasniqi: Pajtohem me propozimin e Albanit dhe nëse ka ndryshime në shumë BIK-u deri në mbledhjen e ardhshme duhet të sjell një dokument formal për rritjen e shpenzimeve që i kanë paraparë e që disa ajnë të arsyeshme.

Kryesues mund të jemi cak i kritikave të diskriminimit të grupve tjera fetare prandaj duhet të nxjerrim një vendim tjetër i cili është jashtë kësaj marrëveshje direkt nga Kuvendi e që të autorizohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që për shumën e njëjtë sa është marrëveshja që të gjithë qytetarët e komuniteteve tjera fetare pa dallim që të marrin këtë drejtë përmes drejtorisë.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Mendoj që kjo marrëveshje ka vlerë më të madhe se sa këto lojëra politike që po bëhen këtu.

Do të doja që të dëgjoja edhe mendimin e këshilltarit ligjor për çështjen për të cilën po dyshoj që KPF-ja ka të drejtë që të hartoj marrëveshjen me gjithë ato rekomandime pa ardhur edhe njëherë në Asamble që të votohet.

Ne si grup e përkrahim këtë marrëveshje me gjithë ato ndryshime dhe plotësime po kërkohen të bëhen këtu duke kërkuar një llogari, transparencë më të madhe nga ana e BIK-ut.

Halil Morina: Përshendetje për ju të pranishëm në sallë! Pasi që kam qenë kryetar i Komisionit për Shpenzimet e Varrimit po e kërkojë të drejtën e fjalës për këtë çështje. Në draft-marrëveshje janë të përfshira shumica e rekomandimeve që i kemi dhënë ne si komision dhe për këtë e falemnderoj Kryetarin.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne e përkrahim propozimin e Alban Mazrekut dhe marrëveshjen.

Rrahim Morina: Tani duhet të ndryshohet neni 8, përkatësisht alilea 8.1 shuma 200€, të kërkohet nga BIK-u që të bie një specifikacion për rritjen e shumës në 230€ e më pas të futen të gjitha rekomandimet e komisionit në marrëveshje. Kush është pro?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 3

Shkojmë për nxjerrjen e një vendimi që të obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që t'i përmbush obligimet për shpenzimet e varrimit për të gjitha komunitetet tjera fetare dhe qytetarër të tjerë pa dallim me shumën e njëte 230€. Kush është për?

Për: 26

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018. Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Do ta pasqyrojë në pika të shkurtëra Raporitn Finaciar për periudhën Janar-dhjetor 2018. Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Finacave Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Finaca ka përgatitur këtë raport finaciar në bazë të standardeve të kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Në bazë të dhënave të prezantuara në tabletat përkatëse në këtë raport rezulton se Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2018 me shumën 14,103,724.06€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj shumë i shtohen donacionet nga qeveria zvicerane, granti i performancës në vlerë 77,964.00€ si dhe bartjet e disa shumave të vogla të mbetura nga donacionet e viteve të kaluara në vlerë prej 1,123.00€, finacimet nga huamarrja 19,042.56€ si dhe mbështetja nga qeveria sipas vendimit 07/80 në shumë prej 200,000.00€ dhe mjetet e bartura nga viti 2017 në shumë 92,663.67€ dhe minusimi i mjeteve prej 3,858.00€ nga pagat nga ana e Ministrisë së Financave del se shuma totale e buxhetit të regjistruar në SMFP për K. e Malishevës në fund të vitit fiskal arrinë vlerën 14,490,658.93€. Buxheti i alokuar për këtë periudhë kap vlerën 14,256,565.53€ që d.m.th që shkalla e realizimit të buxhetit në total është 98.38%. Sipas shënimeve të librave të thesarit del që shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për këtë periudhë është 99.18%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë është 97.58% .

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit realizimi, shpenzimi sipas programeve, sipas burimeve, sipas kategorive ekonomike në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar- Djetor 2018.

Sipas buxhetit të K.së Malishevës për vitin 2018 nga të hyrat vetanake janë planifikuar të inkasohen 980,797.00€. Plani i realizimit i të hyrave vetanake për këtë periudhë është të hyra të rregullta 691,454.12€, kurse të hyrat të cilat inkasohen nga gjobat e gjkatave dhe gjobat nga trafiku për këtë periudhë janë 22,210.00€, kurse gjobat në trafik janë 115,820.00€ e që në total janë 829,484.12€.

Pra kjo është paraqitja në pika të shkurtëra e këtij raporti.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Së pari jemi në shqyrtimin e një raporti që është planifikuar në vitin 2017 për vitin 2018. E falemnderoj drejtorin për detajizimin që ka bërë nëpër tabela të raportit.

Ne kemi pasur mundësi që në faza të tjera të raportit kur është raportuar 3-mujori etj. të japim vërejtjet dhe kritikën tona. Mua më erdhi mirë që të hyrat janë realizuar 100% kjo është kulturë e mirë nga qytetarët e Malishevës për pagesën e tatimit.

Te të hyrat vetanake siç janë gjobat nga trafiku e di që për këtë nuk duhet të ketë planifikim sepse nuk e dimë se çka ndodhë por megjithatë e kanë mbuluar atë pjesën e të hyrave vetanake dhe e kanë realizuar 100%. Nga të hyrat vetanake nuk pashë që ka të hyra nga Agjensioni i pyjeve e kam dëgjuar që janë shqiptuar gjoba për prerjen ilegale të pyjeve. Kam një kritikë për rojet e pyjeve që nuk shqiptojnë gjoba dhe nuk marrin masa për këtë dukuri.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve shkon për paga e që janë në sistem e që janë shpenzime të planifikuara.

Për disa projekte kapitale e kam vë re që janë bërë disa devijime me arsyetimin tek rrugët për shkak të gjërësisë e diku diku ka pengesa edhe na qytetarët etj. Gjithkund ndodhin devijimet por këto është dashur të ndodhin me vendim të Asamblesë.

Sipas Drejtorisë së Financave kjo shprehja e përqindjes më knaq kur është 97.58% sepse është shumë me rëndësi një realizimi i tillë.

Kam disa vërejtje për shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve ku vlera pak është e madhe dhe duhet të kemi kujdes tek kursimet, për drekat zyrtare etj.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Është e vërtetë që ky raport në faza ka ardh edhe më heret por vërejtjet dhe sugjerimet tona asnjëherë nuk janë përfillur dhe vazhdon e njëjta logjikë e raportimit.

Sylë, për çështjen e Agjencionit të pyjeve ne kemi pasur vërejtje për 3 raportet që kanë ardhur dhe për Drejtorinë e Inspektoriatit që nuk kanë pasur të hyra nga ky sektor.

Sa i përket të hyrave vetanake e vërtetë që janë realizuar 100% por për këtë më shumë janë policia meritore se sa ju si ekzekutiv, por çka është e mirë është mirë.

Për mua shqetësuese janë shpenzimet për Mallëra dhe Shërbime ku ka një rritje nga viti 2017 po thuajse të dyfishuara për vitin 2018, pra 405,000€ është rritja.

Pothuajse në të gjitha zërat ka pasur rritje: te shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit janë të dyfishuara, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë më shumë se të dyfishuara, shpenzimet e telefonisë mobile janë të katërfishuara, shërbimet postare që nga 194€ janë bërë 6,338.00€ pse është kjo rritje kaq e madhe? Shpenzimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, çfarë janë

këto shpenzime duam sqarm për këtë? Shërbimet te shtypit, jo marketingu në vitin 2017 s'ka pasur fare, tani 5,400€. Shpenzimet e arsimit trajnime janë të dyfishuara, shpenzimet kontraktuese tjera që janë të trefishuara e që nuk janë të specifikuara se për çka janë këto shpenzime, ne duam dëshmitë e pagesave për këto.

Shqetësuese për ne janë edhe vendimet për gjrobat e gjykatave e që ju duhet t'na siguron dëshmi për këto 90,000.00€ që po i shpenzohen komunës. Cilat janë ato raste që i keni humbur?

Përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive e kemi diskutuar edhe në KPF dhe pse nuk ka Drejtoria e Inspektoritati kod të vetin buxhetor? Kjo drejtori i bie që po funksionon ilegalisht për deri sa nuk ka kod zyrtar.

Shqetësuese është se si është e mundur që projektet kapitale të raportohen si të shpenzuara për punë të pakryera, Valon? Ka disa raste të tilla dhe njëri nga ta është kanalizimi në fshatin Marali ku këtu po reaportohet si projekt i përfunduar e realisht aty s'kanë punuar e nuk po dihet se ku janë shku këto mjete sepse janë raportuar si të shpenzuara tani njëjtë është për fushën e sporteve në Shkozë e raste të tjera që s'po i përmend.

Alban Krasniqi: Ky lloj i raportimit është i nivelit më të ulët të raportimeve të 14 mil € të buxhetit të tërësishëm të komunës. Ky raport është fyes për mua. Këtu nuk respektohet asnjë procedurë, shkelen të drejtat e qytetarëve, tejkalohen shpenzime, bareten shpenzime andej e këndeje dhe askush nuk jep përgjegjësi. A e kuptoni ju o Valon e Kryetar që këto pare nuk janë të juajat, por të qytetarëve atëherë trajtoni si të tilla.

Te shpenzimet kapitale, ndertimi i rrugës minitraziti Veselaj-Banjë 399,846.00€ ku thuhet që 96% është realizuar projekti por më besoni as që ka filluar të punohet. E di që me një vendim të Kryetarit ju mjtet i keni bartë, ne i kemi kërkuar këto sqarime edhe me shkresë por ju nuk na jeni përgjigjur. Nuk e di se çka me ba me juve, sepse po e prekni durimin e njerëzve!

Projektet me bashkëfinacim kujdesi shëndetësor për familje 176,000.00€ e na nuk po e dimë se nga kanë shkuar këto pare. Në bazë të këtij raporti nuk po e dimë se çka është duke ndodhur me buxhetin e Malishevës. Çka me diskutu për këtë buxhet kur nuk i kemi informacionet bazë, informacionet për projektet dhe nderyshimine tyre që këtu po figuron si të shpenzuara e projektet nuk kanë përfunduar e ka nga ata që ende s'kanë filluar.

Valon, a është ndërtuar ndonjë aneks në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku"? Këtu shkruan që 170,000.00€ janë shpenzuar për këtë aneks dhe që 99% projekti është realizuar.

Tjetër është mirëmbajtja e kanalizime, shtrimi i rrugëve që këtu figurojnë si të shpenzuara a puntë nuk janë kryer. Jemi lodhur nga kjo!

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kryesues, para raportit po ndërlidhem me ju. Rregullorja e Punës së Kuvendit e thotë shumë qartë se sa e kanë të lejuar anëtarët e Kuvendit të diskutojnë për një çështje, mirëpo kjo Rregullore po shkelet këtu dhe ju lejohet tejkalimi i minutazhës së diskutimeve të disa anëtarëve të Kuvendit e cial vlenë veç për disa. Kryesues trajtoni në mënyrë të barabartë të gjitha grupet politike këtu!

Më vjen mirë që realizimi te të hyrat vetanake është 101% dhe vlenë për t'u përshendetur.

Drejtor, a është duke u shpërndarë paraja nga të hyrat vetanake në drejtim të realizimit të prioriteteve të indentifikuara për qëllim të përfitimit të qytetarëve?

Në faqe 17, janë disa rritje të shpenzimeve siç janë: shpenzimet e telefonisë mobile, shpenzimet e arsimit dhe trajnimeve dua të di se çfarë lloj trajnime janë realizuar në këtë fushë? Shpenzimet kontraktuese tjera, furnizime për zyre, vaj për ngrohje, dru, mirëmbajtje të automjeteve, dreka zyrtare si dhe rritja për shpenzimet komunale ujë dhe mbeturina. Pse janë këto rritje drejtor?

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Po ndërlihem me fjalën e prafolëses që mua në një raport për një gabim për dy pika pati kritikuar ndërsa për këtë raport asnjë nga ju nuk doli për ti kritikuar ato gabime ose gjëra negative.

Shpenzimet e udhtimive mbrenda vendit janë dyfish të rritura krahasuar me vitin e kaluar, shpenzimet e telefonisë janë tepër të mëdha, shërbimet postare janë të shumëfishuara nga viti i kaluar e shumë shpenzime tjera që i përmendi Hashimi. Shpenzimet e varrimit janë të trefishuara, paisje tjera çka janë këto paisje tjera? Furnizimi për zyre është 60,000.00€. Cilat janë këto furnizime për sa zyre është fjala?

Është për të ardhur keq dhe është e turpshme ku afërsit 40% pyetje është duke u djegur e ju si ekzekutiv nuk keni marrur asnjë masë. Pse Drejtoria e Inspektoriatit nuk del në terren e të shoh se si është gjendja dhe nuk është shqiptuar asnjë gjobë.

109,000.00€ janë dhënë për gjykatë veç nëse me këto pare e ka blerë gjykatën për vete Kryterari sepse shuma është shumë e madhe.

Sadije Krasniqi: Kastriot, e di që ato dy pika ty të janë bërë pikë dhe me atë raport e ke treguar punën tënde. Nuk e di a më dëgjove kur unë i shpreha shqetësimet dhe vërejtjet mia për këtë raport.

Kastriot Berisha: Kolege, pajtohem me atë gabimin që një –ë kam harruar t’ia vë dy pika, por është e pamoralshme që dy pikat e –ë t’i krahasosh me këtë raport të buxhetit e ku ka para që vjdhen.

Hamëz Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Në raport e pash një fushtë të sportit në Shkozë, por në cilin vend është ajo?!

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë të pranishmit këtu! Ky raport është i ngjashëm edhe raportet 3-mujor, 6-mujor dhe 9-mujor, veçse këtu është janë përfshi edhe 3 muajt e fundit. Drejtor, duhet që të mësohemi që raporti të vjen i kopletuar edhe me vërejtjet, sugjerimet që bëhen këtu e jo të vie i njëjtë. Shpesh herë kam diskutuar për shumë gjëra këtu që të përmirësohen në të ardhmen që të jenë më të specifikuara ku janë bërë shpenzimet. Pra vërejtjet kur jepen ato duhet që të përmirësohen.

Drejtor për 3-mujorin e parë për 2019-të specifikojeni gjërat siç është rasti i minitransiteit Veselaj-Banjë që këtu është si buxhet i shpenzuar por rruga nuk është ndërtuar. Drejtor unë kam biseduar me ty dhe kam kërkuar që të ndërtohet rruga “Ëilliam Volker” që është 1650m e të lidhet me minitransitin që do të ndërtohet në të ardhmen.

Kur është fjala për rrethojen që shuma është 40,000.00€ a është fjala për rrethojen e shkollës “Ibrahim Mazreku” apo për ndonjë shkollë tjetër sepse nuk është e specifikuar prandaj kam kërkuar që të specifikohet gjërat.

Sa i përket të hyrave vetanake ato kanë qenë të kushtëzuara me subevncione për përfituesit, por mirë që janë realizuar ato që janë planifikuar.

Pasi që jam Kryesuese e Komitetit për Komunitet anëtarët e atij komiteti duan që të dinë për shpenzime 2,000€, çfarë është bërë me ato shpenzime? Ndërsa për Zyrën për Barazi Gjinore për një udhtim me HENDIKOS-in thuhet që janë shpenzuar 2200€.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! Drejtor, sqaroma pikën për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve ku është një mospërputhje e madhe ndërmjet vitit 2017 dhe 2018 ku shuma është e rritur trefish. Pse është kjo rritje?

Te investimet kapitale, rregullimi i kopshtit në shkollën fillore “Emin Duraku” në Dragobil. Drejtor ai kopsht është fituar me punën e nxnëseve dhe mësimdhënësve të asaj shkolle para 4-5 viteve ndërsa ju e keni futur si shpenzim këtë vit me shumën 2,582€. Mos tentoni që të bëni personale punën e tjetër kujt!

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Është mirë që po diskutohet sot kjo pikë sepse është shtyer që sa dhe është mirë që edhe pikat e Kryetarit të mos shtyhen dhe të trajtohen në këtë formë.

Ky raport është për t’u përshendetur dhe asnjëherë kjo komunë nuk ka pasur investime kaq të mëdha duke ja shtuar edhe investimet që vijnë nga niveli qendror me shuma nga 7-10 mil. Shteti i i Zvicrrës e ka dhënë një performancë 77,964.00€ për shkak të punës së mirë që e bëni K. e Malishevës.

Është për t’u përshendetur realizimi i buxhetit në 98% sepse kjo është rezultat i menaxhimit të mirë të finacave.

Kontrollimin më të mirë të buxhtit e bënë auditori i mbrendshëm dhe ai i jashtëm e ka tendeca këtu nga disa asambleistë që nga kontrollimi po mundohen të kalojnë në regjim. Kjo nuk është e mirë. Nëse ka shkelje ligjore është gjykata që vendos për to, sepse atyre ju takon.

Avdi Morina: E falemnderoj drejtorin për një raport të tëill të precizuar dhe të saktë! Prej ardhjes së qeverisë Begaj prej 2014 ti krahasoni raportet me ato të qeverisë së kaluar. krahasoni edhe me komunat tjera ku K. e Malishevës është shembull sepse komunave tjera edhe 50% ju kanë mbetur suficit. Pra krahasoni edhe të hyrat edhe shërbimet që u janë kryer qytetarëve që mjetet të mos shkojnë suficit normalisht që ka shpenzime. Ajo që na pajtohem në këtë rast e që është për qëllim interesi i qytetarëve është që të mos keqmenaxhohet paraja publike, mirëpo jo të jepen vërejtje veç sa për të bërë politikë, kjo është shumë e padrejtë.

Alban Mazreku: Po nisem aty ku e la parafolësi për raportet e së kaluarës nga qeverisja e PDK-së. Ato raporte janë përgatitur nga g të njëjtit njerëz që më vonë kanë qenë pjesë e kësaj qeverie. Drejtori nuk ka bërë raport të mirë ose ka qenë i udhëzuar ta bëjë në këtë mënyrë. U përmend rritja e të hyrave në tatimin në pronë, por ky departament do të kishte edhe më shumë rritje nëse nuk do të kishte interferuar zyrtarët që i lëshojnë ata vërtetima të tatimit në pronë, pa e paguar. Shpenzimet komunale në vitin 2017 kanë qenë 70,000.00€, ndërsa në vitin 2018 janë afërsisht 199,000€. Kjo është një rritje e madhe.

Nga 5.9 mil në vitin 2017 në vitin 2018 janë 6.1 mil është një ngritje e lartë në lëmin e arsimit. Sa i përket shtratis të lumit “Mirusha” nuk është pjesa që shkon në drejtim të Banjës por është pjesa që shkon në drejtim të Mirushës prej Urës së Madhe deri të ura e minitransitit. Këto mjete 30,000€ që kanë qenë të palnifikuara nuk janë realizuar. Është mirë që t’na tregoni se ku kanë shkuar ato mjete. Shpenzimet tjera i përmenden prafolësit e mi kështu që nuk po i përsëriti. Po ju paralajmroj drejtor që të gjithë ata që i kanë keqpërdorur këto para shumë shpejt do të përballen me prokurorinë sepse ne do të punojmë seriozisht në këto çështje.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Në vitin 2018 kishte pas 200,000.00€ bashkëfincime me qytetarët. Unë kam bërë një kërkesë për një lagje të fshatit tim që të jemi

pjesë e atij bashkëfinacimi por nuk është marrur parasysh nga Kryetari dhe drejtori i Urbanizimit. A jemi pjesë edhe ne e qytetarëve të K. së Malishevës, pse nuk është përkrah ajo kërkesë e imja?

Te shpenzimet për Mallëra dhe Shërbime nga viti kaluar janë rritur në total afërsisht 400,000€. Falemnderit!

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! E falemnderoj drejtorin për një raport kaq përmbytësor dhe të shprehur në formën më të mirë të mundëshme!

Në Malishevë jetojmë 24 orë dhe çdo ditë i shohim dhe i vëmë re ato që bëhen dhe është mirë që duke filluar nga ne asambleistët deri te Kryesuesi që puntë e mira që bëhen në Malishevë të përkrahen dhe të vlerësohen, e jo të kritikohen.

Gjuha e cila përdoret këtu në Asamble është fyese, denigruese, jopërmbytësore dhe nuk i bënë nder askujt. Del dikush këtu dhe na moralizon ne për të hyrat dhe shpenzimet në K. e Malishevës duke përdorur shpifje dhe fyrie duke e ngritur zërin, e ka gabim.

Ne e kemi dëshmuar që nga 2013-ta nuk frikësohemi sepse i kemi dalur përballë një pushteti të udhëhequr nga PDK-ja dhe nuk e kemi pasur problem se çka po bëhet me ne, a po mbesim në punë a jo. Ne kemi dalur para qytetarëve me platforma tona dhe secili nag ne është vlerësuar nga qytetarët dhe sot e ka vendin këtu në Asamble.

Kryesues, përveç vendimeve të jashtëligjshme që po merren këtu, ju po lejoni që të përdoret edhe një gjuhë e tillë gjuhë e cila do të shkatërojë probleme të shumica e asambleistëve e sidomos te ata që janë për herë të parë në Asamble, mos e lejoni një gjë të tillë! Janë pikërisht VV që ngrit tema këtu edhe për familje e gjëra të tjera e që shpif e shantazhon. Ne nuk do të lejojmë veprime të tilla! Si rezultat i gjuhës së përdorur në Kuvendin e Komunës së Malishevës sot e shumë herë tjera NISMA nuk do të jetë e pranishme në këtë seancë dhe ne për këto shpifje do të ngrisim edhe padi.

(NISMA lëshon sallën)

Rrahim Morina: Asnjëherë nuk e kam përkrah fajlorin denigrues dhe po bëni akuza shumë të pasinqerta.

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! S'di çka i ka mbet merak Arbreshës për PDK-në dhe para 2013 edhe ajo ka qenë pjesë e PDK-së. Kush ka bërë largim masovik se sa NISMA kur ka ardhur në qeverinë komunale? I ka larguar mbi 150 mësimdhënës. Lidhu për kë të duash por jo për PDK-në.

Rrahim Morina: Shkojmë në pushimine drekës dhe kthehemi në ora 13: 15.

Pas pauzës jemi te pika: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018. A e dëshiron dikush tjetër fjalën?

Nebih Bibaj: Sa i përket raportit, te rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale është vlera 60,000€m por rrugët janë të tërat me gropa. Rregullimi i rrejtëve të kanalizimit nëpër fshatra, nuk specifikohet se për cilat fshatra është fjala. Trotuarët nëpër fshatra vlera është 1,925.47€ në cilat fshatra është bërë kjo? Renovimi i objekteve shkollre nuk specifikohen se në cilat shkolla janë renovuar. Rrethimi i shkollave fillore nuk dihet se cilat shkolla. Rregullimi i fushave të sportit si shpenzim është për Shkozë dhe Berishë, por këro dy fshatra s'kanë fusha të sportit.

Alban Mazreku: Ne si asambleistë ngritem shumë çështje sa i përket raportit të financave për vitin 2018, mirëpo fatkeqsisht asnjëri nga nuk morëm përgjigje nga ekzekutivi sepse ata nuk janë këtu. Unë rekomandoj që pas shumë gjetjeve në këtë raport siç janë çështjet që këtu figurojnë si të shpenzuara e në fakt projektet nuk janë punuar prandaj me këtë rast është mirë që të merren Krimet Ekonomike të Policisë së Kosovës dhe Prokuroria. Kërkoj që këto rekomandime të hidhen në votim e të merret vendim nga asambleistët.

Alban Krasniqi: Pas një konsultimi gjetëm mënyrën se si të adresojmë më drejtë problemin e shfaqur në këtë raport të qeverisjes lokale rekomandohet që këtij raporti t'i bashkangjiten dokumentet siç janë vendimi i Kryetarit i marrur në tetor të vitit të kaluar, si dhe kërkesa e KPF-së për drejtorin e Financave dhe Kryetarit që të japin shpjegimet e nevojshme për mospërputhjen e shumave të projekteve që rezultojnë të kryera në letër e në praktikë fare dhe për mospraninë e drejtorit dhe Kryetarit këtu nuk na mbetet rrugë tjetër përveç që t'i drejtohem insitucioneve të drejtësisë.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim. Propozimi i 3 grupeve politike është që të nxjerrim një rekomandim dhe njeherit të autorizohen shefat e grupeve që këtë çështje ta dërgojmë në organet e drejtësisë për të kërkuar përgjegjësi rreth keqpërdorimeve në disa kode, ato që u përmenden më parë. Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Propozoj që sot të diskutohen sëpari pikat që janë më urgjente për shkak të kohës.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve. Në këtë duhet ta çojmë në debat publik leximin e parë ky është votimi i marë ndërsa votimi i dytë është për të formuar komisionin e këtë mund ta bëjmë në këtë mbledhje.

Kush është për që kësaj Rregullore t'i japim rrugë për debat publik?

Për: 17 (unanimisht)

A po pajtoheni që komisioni të jetë i përbërë nga 5 anëtarë, 2 Nisma, 1 PDK, 1 LDK dhe 1 VV?

Kush është për?

Për: 17 (unanimisht)

Me këtë votim konstatojmë që është formuar edhe komisioni. Nëse i keni propozimet shkojmë me to.

Alban Mazreku: PDK-ja propozon Nebih Bibaj anëtarë të këtij komisioni.

Arlind Morina: Ne LDK-ja propozojmë Valon Krasniqin.

Ilaz Krasniqi: VV-ja propozon Alban Krasniqin anëtarë të këtij komisioni.

Rrahim Morina: I votojmë këta emra në pako. Kush është për që këta të propozuar të jenë pjesë e komisionit?

Për: 16 (unanimisht)

Për ato dy vende që i lamë NISMA njëri le të jetë anëtarë nga Zyra e Kryetarit sepse është Rregullorja për Subvencione. Kush është pro kësaj?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës nr.01/138 datë:08.02.2019 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019. Ju lutem kush është pro miratimit të këtij plani?

Për: 16 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/188 datë:20.02.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për marrjen e vendimit, sipas kërkesës nr.01/176 datë:14.02.2019 të parashtruar nga kryesia e Lagjes Matoshi-Qytetit të Malishevës, për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit të Komunitetit "Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit". Kush është për?

Për: 16 (unanimisht)

Me këtë votim aprovohet kjo kërkesë.

Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/483 i datës 20.11.2018 për lirin nga taksa komunale për leje ndërtimi në bujqësi. Kush është për shfuqizimin e këtij vendimi?

Për: 16 (unanimisht)

Me këtë votim shfuqizohet vendimi për lirin nga taksa komunale për leje ndërtimi në bujqësi. I kemi pikat për ndërrim destinim dhe ju po kërkon që të pestat t'i debatojmë në pako apo. Në rregull po i lexoj. Pika e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/11 datë:07.02.2019 të parashtruar nga Feim Krasniqi nga fshati Lashkadrenoc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Pika e 15-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/12 datë:09.02.2019 të parashtruar nga Ismet Rudaj nga fshati Panorc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Pika e 16-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/14 datë:08.02.2019 të parashtruar nga Baki Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Pika e 17-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/22 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Bahte Bytyqi nga fshati Shkozë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe pika e 18-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/31 datë:18.03.2019 të parashtruar nga Blerim Krasniqi nga fshati Lashkadrenoc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Për këto pika që janë të natyrës së njëte debatin mund ta bëjmë të përbashkët ndërsa votimin një për një.

Alban Mazreku: Kryesues nëse nuk është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit propozojmë që këto pika t'i votojmë në pako ama vendimi të nxjerret për secilën veç e veç.

Rrahim Morina: Mbase po pajtoheni i votojmë në pako e ndërsa vendimin e nxjerrim për secilën veç e veç. Kush është pro miratimit të këtyre kërkesave?

Për: 16 (unanimisht)

Me këtë votim aprovohen 5 kërkesat e qytetarëve për ndërrimin dhe destinimin e tokës bujqësore në ndërtimore.

Kalojmë në pikën e 19-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/158 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, për caktimin e zonës së mbrojtur të Memorialit të UÇK-së në kodrën e quajtur Golesh në Malishevë. E hapi debatin për këtë pikë.

Ilaz Krasniqi: Kërkesa e këtij komiteti është për caktimin e zonës së mbrojtur të Memorialit të UÇK-së në kodrën e quajtur Golesh në Malishevë si dhe futjen e këtij Memoriali nën përkujdesjen e Komunës së Malishevës.

1. Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale kërkojmë që Kuvendi i Komunës të nxjerrë vendim me anë të cilit caktohet zona e Memorialit të UÇK-së në kodrën e quajtur Golesh dhe me anë të këtij vendimi të obligohet K. e Malishevës që të merr në përkujdesje dhe mirëmbajtje këtë Memorial.
2. Të përcaktohet qartë zona e Memorialit dhe në taë zonë mosplanifikohet dhe të mos lejohet ndërtimi. Komuna të merr në kontroll dhe të mirëmbaj Memorialin.
3. Të planifikohet buxhet për secilin vit për nevojat e këtij Memoriali siç është ndërtimi i flamurit në prag të festave kombëtare, pastrimi dhe ngjyrosja e shkronjave dhe të bëhen investime tjera në rregullimi e Memorialit.

Ne si komision i kemi nxjerru në Kadastër dhe kjo parcelë aty afërsisht është 4 hektarë. Prandaj ne si komitet kërkojmë që kjo zonë të shpallet zone e interesit të përgjithëshëm. Aty janë edhe tri troje që nëse e pegojnë Memeriolin të largohen sipas kërkesës që është.

Valon Krasniqi: Grupi ynë e përkrahë këtë kërkesë dhe pas miratimit të kësaj kërkesë duhet të zbatohet e jo veç të miratohen këto vendime sa për sy e faqe.

Rrahim Morina: Këtu është çështja edhe atyre 3 trojeve dhe çështja duhet të analizohet pak më mirë. A ka hapësire me i nda vend për ato 3 troje dhe ku me i çu ato.

Alban Mazreku: Kjo kërkesë do një analizë pak më të gjërë. Nëse 3 pronarë i kanë trojet atje ata munden t'na padisinë në gjykatë. Ne po pajtohemi që kjo zonë të jetë e mbrojtur, të ndërrohen flamujt dhe të ndahet buxhet. Por ne duhet të mendojmë se çka do të ndodh me këto 3 troje. Mendoj që kjo duhet të diskutohet në mes të shefave të grupeve si çështje dhe të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër e pastaj të marrim vendim.

Alban Krasniqi: Çështja e pronave që përmendi Baci Ilaz nuk ka lidhje me vendimin që ne do të marrim sot. As nuk preket me vendimin tonë çështja e atyre pronave. Kur është marrë iniciativa për ndërtimin e Memorialit vet Kryetari e ka dhënë si propozim që në të ardhmen nëse e pengojnë këtë pjesën e UÇK-së këto troje që janë më shumë se tri atëherë komuna do të bëjë zgjidhje. Vendimi i sotëm s'ka të bëjë me ato prona dhe mos e shtyeni për këtë arsye. Kjo u përmend që të ardhmen të rregullohet.

Zona që po kërkohet e Memorialit mund të kombinohet me park, lojëra për fëmijë, vendqendrim për pensionistë dhe të gjelbrohet natyra dhe ne duhet t'i japim rrugë kësaj ideje dhe nuk shoh ndonjë dyshim që kjo mos të kalojë dhe 3 hektarë për këtë çështje nuk janë shumë. Nëse ne jemi kundër Memorialit dhe kundër kësaj hapësire të ndahet nuk e di më se çka kemi me fol këtu.

Rrahim Morina: Është mirë që të shkojmë në një pauzë prej 5 min që të diskutohet kjo çështje.

Kush është për?

Për: uanimisht

Shkojmë në pauzë për konsultime.

Pas këtyre konsultimeve fjalën e ka Ilazi.

Ilaz Krasniqi: Pas konsultimeve me shefate e grupeve politike ne u dakorduar qe 1 hektarë e gjysmë të jetë zonë e Memorialit kurse pjesa tjetër të jetë zonë e mbrojtur e kësaj zone kadastrale.

Alban Krasniqi: Për mua është e pakuptueshme pse nuk po kalohet e tërë zona në emër të Memorialit të UÇK-së. Nëse PDK-ja po kërkon që të ulet volumi për Memorialin e që pjesa tjetër të lihet si zonë e mbrojtur dhe nuk e kuptoj hezitimin e tyre që nuk po e pranojnë si të tërë. Megjithatë ne do ta votojmë propozimin e konsultimeve meqenëse po shpallet si zonë e interesit.

Rrahim Morina: Nuk e di a ka të drejtë Kuvendi të shpallë zona të mbrojtura.

Muharrem Morina: Çështja e përcaktimit si zonë e mbrojtur është fjala si koncept. Ndoshta është ma mirë që zona të përcaktohet si lokacion i Memorialit të UÇK-së e jo të quhet zonë e mbrojtur sepse ne e dimë cilat janë zonat e mbrojtura. Tjetra është që mos ajo zonë sipas PZHK-ës është e përcaktuar për diçka tjetër që të mos bie ndesh ky vendim me atë tjetrin që do të merrni më vonë.

Kastriot Berisha: Propozoj që pjesa tjetër e lokacionit të ceket si Parku i Memorialit të UÇK-së kështu që edhe parku të jetë në tërsinë e Memorialit të UÇK-së.

Rrahim Morina: Sipas koncensusit sipërfaqja prej 3 hektarëve e 80 ari të jetë Park i Memorialit të UÇK-së. Kush është për?

Për: 16 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 20-të të rendit të ditës: Shqyrtim i kërkesës nr.02/131 datë:11.03.2019 të parashtruar nga banorët e lagjes Brahaj nga fshatit Carrallukë. Këtë kërkesë mund t'ja rekomandojmë Drejtorisë së Urbanizimit pastaj ata le të merren me këtë punë. E hapi debatin për këtë pikë.

Ilaz Krasniqi: Mbase nuk është ekzekutivi këtu është e pakuptimtë të diskutojmë këtë çështje. Banorët e lagjes "Brahaj" të fshatit Carrallukë kanë bërë një petition për diskriminimin që u është bërë asaj lagje për mos investime. Kjo lagje ka 13 shtëpi dhe petitionin e kanë nënshkruar 27 banorë. Kërkesa e parë e tyre është t'ju shtrohet rruga 320 metra gjatësi.

Alban Krasniqi: Në projekt-buxhet janë 2-3 linja ku kemi rrugë të njëjta ku janë të shtruar edhe me kubëza edhe me asfalt e sasia është e madhe e që është e mjaftueshme se kur të korrigjohet dhe të zëvendsohen ato rrugë me këto rrugë të reja që nuk janë në planifikim.

Rrahim Morina: Atëherë kush është pro që këtë kërkesë t'ja rekomandojmë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Financave që ato nëse kanë mjete të buxhetit ta rregulloj këtë çështje?

Për: 16 (Unanimisht)

Kalojmë në pikën e 21-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave për ndërtim të shtëpive për familjet e pa strehë. Ne kemi pasur disa kërkesa të natyrës së tillë dhe i kemi përfshi në një pikë e që të debatojmë për këtë çështje. E hapi debatin për këtë pikë.

Kastriot Berisha: Sa i përket kësaj teme rekomandoj që secili që e bënë një kërkesë me të dhëna dhe të bëhet një komision nga asambleistët me gjithë Kryesuesin që të dalin në terren dhe

të verifikojnë se si i kanë kushtet. Kjo është e mirë që shtëpitë mos të shkojnë veç tek militantët partiak por për të gjithë ata që kanë nevojë.

Valon Krasniqi: Pajtohem me propozimin e Kastrioti po ashtu të verifikohet gjendja në terren e gjithë atyre që paraqesin kërkesa për ndërtimin e shtëpive të familjeve të pa streha. Ka raste kur komuna i anashkalon rastet ekstrme dhe i përkrah rastet ku janë militantët e vet, prandaj ne duhet të dalim me disa rekomandime për këtë çështje dhe të krijohet një lloj komisioni për çështjen e tillë.

Alban Krasniqi: Kjo pikë ka ardhur këtu për shkak të mungesës së një mekanizmi se si adresohen kërkesat e shumë qytetarëve. Ka pasur disa probleme në këtë drejtim. Më shumë ka qenë në vullnetin e Kryetarit se ku e ka çu një shtëpi dhe çfarë shtëpie të ndërtojë. Format i shtëpvie ka qenë i njëti si për dy anëtarë si për 5 e më shumë anëtarë. Ka kërkesa që 1 vit e sa e që mbesin në sirtarë e nuk trajtohen dhe kemi kërkesa që për 2 muaj e gjejnë trajtimin. Kjo është mungesë e transparencës.

Ka ndarje të caktuar buxhetore për shtëpi. Nëse s'ka ne duhet të gjejmë burimin se nga duhet të ndahen këto mjete e që mbledhjen e ardhshme nga drejtori. Duhet të dihen se cialt janë procedurat që nga palët duhet të respektohen ose të aplikohen. Neve na duhet edhe lista e kërkesave të tilla. Kur t'i kemi të gjitha këto ne atëherë ne mund të marrim një vendim për ndryshim e një pjese të buxhetit për ndërtimin e shtëpive për këtë vit, të ndërtohen disa kriteret të qarta se si ndërtohet shtëpia deri te pranimi teknik.

Kërkoj që këto kërkesa të drejtohen edhe njëherë te Kryetari për përgjigje e nëse nuk marrin përgjigje të drejtohen tek ne si Kuvend e që e kemi të drejtën të marrim vendime që krejtë këtë t'ja bartim Kuvendit e kërkesat të trajtohen në KPF e më pas në Kuvend.

Ali Morina: Kjo temë është e ndjeshme dhe për mua është shqetësuese kur qytetarët i drejtohen Zyres së Kryetarit me kërkesa por nuk marrin përgjigje. Një rast konkret e kemi të veteranit të UÇK-së Zenel Thaçi kërkesa e fundit e të cilit që 5 muaj që s'ka marr përgjigje as pozitive as negative. Qytetarët duhet të marrin një përgjigje çfarëdo qoftë ajo.

Valon Krasniqi: Kryesues është mirë që të formohet një komision ashtu siç thamë që familjet e tilla a i plotësojnë kriteret në mënyrë që të dimë që paraja e qytetarëve a po shkon në vendin e duhur ku nevojat janë asisoi. Me këtë rast e falemnderoj Halil Kastratin që po ndërton tri shtëpi në Kërvasari dhe mërgimtarin Bashkim Shala që po i ndihmon këto kategori.

Muharrem Morina: Sipas praktikës që nga 2014 deri në muajin qershor grumbullohen kërkesat për strehim të familjeve dhe pastaj është formu komisioni i cili i shqyrton dhe i verifikon këto kërkesa dhe ja rekomandon Kryetarit për 5 familje ndërtimin e shtëpive. Kryetari i inicon procedurat e prokurimit Sa i përket rastit të Zenel Thaçit dhe e kemi kërkesën e tij. Çdo vit ne u kthejmë përgjigje secilës kërkesë. Nëse Kuvendi e nxjerrë një rregullore për këtë çështje dhe i përcakton kriteret pastaj kërkohet llogari nga komisioni nëse nuk u është përmbajtur atyre.

Rrahim Morina: Ne mund ta formojmë një komision me përbërje prej 5 anëtarë një të jetë nga Kryetari dhe nga një nga subjektet politike. Atëherë kush është pro?
Për: 17 (unanimisht)

Ky komision do të merret me rregullore dhe vënien e kriterëve për familjet në nevojë për strehim familjar.

Kalojmë në pikën e 22-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/164 datë: 13.03.2019 të parashtruar nga e fshatit Llazicë, Vermicë dhe Drenoc. Këta banorë nuk kanë kyçje në autostradë dhe po kërkojnë kyçje në austradë. Këtë çështje e kemi diskutuar në KPF dhe kemi konstatuar që të autorizohet Drejtoria e Urbanizmit që të del në terren të shoh gjendjen reale dhe në bashkëpunim me Ministrinë t'ua mundsojnë kyçjen këtyre banorëve në autostradë. Gjithashtu kjo kërkesë i drejtohet edhe Kryetarit të Komunës. Kush është pro?

Për: 17 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 23-të të rendit të ditës: Miratimi i dorëheqjes së anëtares znj. Vera Bytyçi nga Komiteti për Barazi Gjinore. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë nuk e ka vendin këtu. Ne mund të marrim vetëm një vendim për heqjen e drjtës së votimit në Komision për Barazi Gjinore, pra me qenë anëtare pa të drejtë vote. Ky rast është i veçantë dhe nuk është dashur kjo çështje të vie këtu.

Rrahim Morina: Vera ka bërë kërkesë me shkrim dhe thotë që është në kundërshtim me ligjin dhe kërkon dorëheqje. Kuvendi e ka zgjedhur si anëtare në këtë rast edhe Kuvendi e shakrkon nga kjo detyrë.

Hidajete Mazreku: Nga provoja në Komitetin për Komunitete e kemi Zyrtarin për Komunitet dhe ai nuk ka të drejtë me qenë anëtar i Komitetit sepse është konflikt i interesit. Njëjtë edhe Vera mundet me qenë monitoruese mirëpo të drejtë vote Vera nuk ka në atë komitet dhe me qenë anëtare. Për këtë arsye Vera me plotë mençuri e ka sjellur këtë kërkesë këtu.

Alban Mazreku: Zonja në fjalë ka bërë kërkesë për dorëheqje dhe ne duhet t'ja aprovojmë dhe propozoj që vend të saj të shkoj Isuf Morina zyrtar i Kryqit të Kuq dega në Malishevë.

Alban Krasniqi: Më fal profesorëshë, por je gabim! Komiteti për Barazi Gjinore është jashtë komiteteve të përhershme dhe pa praninë e zyrtares për Barazi Gjinore ai komitet nuk ka rëndësi të funksionimit. Nëse jeni që ta heqni krejt këtë komitet është tjetër gjë. Nëse zyrtarja në fjalë e ka parë problemin e konfliktit të interesit janë rrugë tjera që duhet ndjekur. Nëse kjo zyrtare këtë kërkesë do ta dërgonte në Ministri do të ishte e kuptueshme. Ne nuk votojmë individë por votojmë pozicione. Ne nuk e kemi votuar Verën si individë, por zyrtarën për Barazi Gjinore sepse funksionimi i komitetit është i lidhur me këtë pozicion. Problemi i saj ka qenë çështja e votimit dhe ne mund tja heqim të drejtën e votës.

Muharrem Morina: Konflikti i interesi krijohet vetëm në raste kur zyrtari merr pjesë në një vendimmarrje dhe nga jao përfiton vet osë një anëtar i familjes në vijë të drejtë pa kufi e në vi të tërthortë deri në shkallën e 4-ërt. Nuk e di që ky komision merr vendime që përfitojnë për vetëvetën ata. Ata i rekomandojnë Kryetarit dhe Kuvendit politikën e çështjeve gjinore. Për mendimin tim profesional këtu nuk ka konflikt të interesit sepse Kuvendi është ai që i merr vendimet komitet rekomandojnë përveç KPF-së.

Rrahim Morina: Ajo ka sjellë dorëheqjen me shkrim dhe ne e hudhim në votim. Kush është pro aprovimit të dorëheqjes së Vera Bytyqit nga Komisioni për Barazi Gjinore?

(Alban Krasniqi nuk merr pjesë në votim e lëshon sallën)

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 1

Është një propozim nga Alban Mazreku që në vend të Veres të jetë Isuf Morina zyrtar i Kryqit të Kuq në Malishevë. Kush është për?

Për: 14


Kundër: 0

Abstenim: 2

Me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur duke ju falemnderuar për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 15: 12.

Procesmbajtësja Samire Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

